



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilajeno / Prilato Received / Delivery	28-05-2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHTEK	2706/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.310/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Kocanëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.310/2021, të datës 27.04.2021, të ankuesit _____, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. _____ me adresë rr. "Zenel Salihu" nr.28, kati i III/8, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **Shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.310/2021 të datës 27.04.2021, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi _____ sipas Dekretit me numër 255/2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës me datën 09.12.2019, është emëruar "Konsull i Përgjithshëm" në Republikën e Maqedonisë Veriore me seli ne Shkup. Me datën 25.11.2020, Ushtruesja e Detyrës së Presidentit të Kosovës, ka nxjerr dekretin me numër 166/2020, me të cilin e ka shfuqizuar dekretin me numër Nr.255/2019 të datës 09.12.2019, lidhur me emërimin e ankuesit në pozitën Konsull i Përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Me datën 16.04.2021, Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerr vendimin me numër Nr.25/2021, me të cilin e ka liruar nga pozita e Konsullit të Përgjithshëm ankuesin nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Shkup, me qëllim të zbatimit të dekretit me numër 166/2020, të ushtrues së detyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër Nr.25/2021 të datës 16.04.2021, të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 27.04.2021, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 1853/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 29.04.2021, e ka proceduar ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për përgjigje në ankesë, ndërsa me datën 11.05.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me provat e bashkangjitura.

Administrimi i provave: Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa e ankuesit me numër protokollit 2029/20201 e datës 27.04.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rekomandim me numër Nr.ref.417/2019 i datës 21.08.2019; Dekreti me numër 255/2019; Njoftim i datës 09.12.2019 me numër Nr.Prot.1651/1; Vendim i datës 24.12.2019 me numër Nr.Ref 275/; Shkrese zyrtare e datës 30.12.2019; Karta identifikuese e ankuesit; Formulari i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2020 i datës 28.10.2020; Vendim i datës 16.04.2021 me numër Nr.25/2021; Prokurë speciale e datës 26.04.2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 29.04.2021; Përgjigja në ankesë e datës 06.05.2021 me shkresat e bashkangjitura; Vendim i datës 04.12.2019 me numër Nr.Ref.480/2019; Njoftim i datës 27.11.2020 me numër 2242; Dekreti me numër 166/2020 i datës 25.11.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj ankese, pasi ka shqyrtuar te gjitha shkresat e lendes te parashtruara nga ankuesi dhe organi i punësimit respektivisht Dekretin me numër 255/2019 te Presidentit të Republikës së Kosovës të datës 09.12.2019 me të cilin ankuesi është emëruar "Konsull i Përgjithshëm" në Shkup, ka konstatuar Kolegji për shqyrtimin e ankesave i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për shqyrtimin e kësaj ankese, pasi qe ankuesi nuk ka status te nëpunësit civil ne baze te nenit 3 paragrafi 2 nen paragrafit 2.3 te Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *Ky ligj nuk zbatohet për: 2.3. funksionaret e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura*, sepse në rastin konkret krijimi i marrëdhënies së punës së ankuesit është bërë ne bazë te emërimit te datës 09.12.2019, sipas dekretit me numër Nr. i Dekretit:255/2019 nga Presidenti i Republikës së Kosovës ashtu siç parashihet edhe me nenin 7 paragrafin 7.1, 7.8 dhe 7.10 te Ligjit Nr.03/L-207 Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve te Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës ku thuhet se : *"7.1. Emerimi i Ambasadorëve dhe Shefave te Misioneve behet nga Presidenti i Republikës se Kosovës me dekret", "7.8. Te emëruarit ne pozitën e Ambasadorit dhe Shefit te Misionit qe nuk janë anëtarë ne detyre te Shërbimit te Jashtëm te Republikës se Kosovës shërbejnë vetëm për një mandat dhe pas përfundimit të këtij mandati, nuk konsiderohen pjese e Shërbimit te Jashtëm dhe "7.10. Emerimi i Konsujve te Përgjithshëm bëhet me dekret të Presidentit te Republikës se Kosovës".*

Bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm te Republikës se Kosovës, pranimi ne shërbim te jashtëm behet nëpërmjet konkursit te hapur si dhe ne pajtim me Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik si dhe legjislacionit në fuqi. Ndërlidhur me këtë neni 8 i Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe

Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës ka përcaktuar se "Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së ambasadave dhe misioneve ose zyrave tjera jashtë Kosovës. Andaj bazuar në këto dispozita ligjore, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se Këshilli nuk është kompetent për të shqyrtuar ankesën e ankuesit sepse në bazë të dëshmive të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ankuesi nuk është pranuar në shërbim të jashtëm nëpërmjet konkursit të hapur dhe nuk ka nënshkruar Akt emërimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme, por ai është emëruar me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës respektivisht është i emëruar me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës respektivisht është i emëruar politik vetëm për një mandat dhe pas përfundimit të këtij mandati, nuk konsiderohet pjesë e Shërbimit të Jashtëm dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka asnjë obligim për sistemimin e ankuesit në shërbimin e jashtëm.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lendes si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.


Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr.A.nr.310/2021

Malsore Gashi-Bajraktari



Kryetare e Kolegjit

Ardita Perçuku-Shyti



Procesmbajtëse

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- Arkivit të KPMSHCK-së

